




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRAÇANICA

Në bazë të nenit 52 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 11 të Udhëzimit administrativ nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë, nenit 25 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa thërret mbledhjen e jashtëzakonshme dhe dërgon:

FTESË

I nderuar,

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e pestë të jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet të premten më datën 15.11.2024. Mbledhja do të fillojë në orën 11:30.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit, kati i parë nr.2.11 në objektin e Komunës së Graçanicës në Graçanicë.

Të bashkëngjitur me ftesë gjeni rendin e ditës dhe materialin për këtë mbledhje. Për këtë mbledhje është caktuar ky:

REND I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e rregullt, e mbajtur më datën 31.10.2024.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për rritjen e buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për caktimin e normave tatimore për pronën e paluajtshme për vitin 2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së NPK "Ekologjia" Sh.A. Graçanicë për ndarjen e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër, me propozim të drejtorit ekzekutiv të NPK "Ekologjia" Sh.A. Graçanicë, Dejan Dimitrijeviq.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për ndryshimin dhe plotësimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve në mes të Komunës së Graçanicës dhe NPK "Ekologjia" Sh.a. Graçanicë, me propozim të kryetarit të Kuvendit të aksionarëve të NPK "Ekologjia" Sh.a. Graçanicë, Sasha Daniq.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për ndryshimin e emrit të rrugëve, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq.
7. Pyetjet dhe përgjigjet nga mbledhja e tretë e jashtëzakonshme e KK të Graçanicës, e mbajtur më datën 24.09.2024.
8. Të ndryshme.

Me respekt
Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa

Milan Dimitrijević

